



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 286, Datë 20.12.2024

MBI

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË
OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 3.5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar; Kushteve të Përgjithshme, Seksionit B.4.5.6. të “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar; nenit 3 pika 8 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2583 prot., datë 18.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi miratimin e Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të emëruar të tregut të energjisë elektrike (Nemo)”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 287, datë 09.10.2023, vendosi, ndër të tjera, fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike”. Në këtë kuadër, u përcaktua që shoqëria ALPEX sh.a. të vijojë me përditësimin e metodologjisë gjatë procesit konsultativ, duke mundësuar që ERE të shqyrtojë dhe miratojë metodologjinë.
- Sipas nenit 6, pikave 6.1 dhe 6.4 të “Marrëveshjes Kornizë” mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, ERE dhe ZRRE duhet të miratojnë një metodologji të përbashkët për tarifatat e NEMO-s, bazuar në parime dhe metoda të njëjta. Në këtë kuadër, palët kanë zhvilluar komunikime dhe shkëmbyer propozime për draft-

- metodologjinë, duke synuar finalizimin dhe miratimin e saj, me përcaktimin e metodës përfundimtare për llogaritjen e të Ardhurave të Lejuara.
- Për të diskutuar parimet e metodologjisë dhe metodës përlllogaritëse të të ardhurave të kërkuara të shoqërisë ALPEX sh.a., që pritet të rikuperohen përmes tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), janë zhvilluar dy takime ndërmjet përfaqësuesve të ERE dhe ZRRE nëpërmjet platformave elektronike, më datat 20.06.2024 dhe 13.09.2024. Gjatë këtyre takimeve, palët ndanë opinione, komente dhe propozime mbi draft-metodologjinë e ALPEX. Në përfundim, u ra parimisht dakord dhe u konkretizua një draft-metodologji je përbashkët për të dy rregullatorët, e cila u përgatit për t'u kaluar në fazën e konsultimit publik.
- ERE, me shkresën nr. 2414 prot., datë 18.11.2024, njoftoi publikimin e draft-metodologjisë në faqen zyrtare të internetit dhe ftoi palët e interesit për komente. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 2414/1 prot., datë 10.12.2024, shprehu dakordësinë parimore për metodologjinë, me kusht që tarifat të përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë metodologji.
- Në përfundim të procesit konsultativ, rregullatorët e Shqipërisë dhe Kosovës finalizuan draftin përfundimtar të metodologjisë, e cila përcakton parimet rregullatore dhe metodën për përlllogaritjen e të Ardhurave të Lejuara të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), duke siguruar tarifa të drejta dhe kosto-reflektuese për pjesëmarrësit e tregut.
- Metodologjia për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, përbëhet nga 4 kapituj dhe tre shtojca specifikuar si vijon:
 - *Në kapitullin e parë*, përcaktohet fushëveprimi dhe qëllimi si dhe përkufizimet e përdorura në metodologji.
 - *Në kapitullin e dytë*, përcaktohen rregullat e përgjithshme të përcaktimit të të ardhurave, Rishikimet e Tarifave dhe Periudhat rregulluese.
 - *Në kapitullin e tretë*, paraqiten parimet e përgjithshme, Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes, Amortizimi i lejuar, Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit, Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës si dhe Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës,
 - *Në kapitullin e katërt*, përcaktohen Parimet e vendosjes së tarifave, Procesi i Miratimit të Tarifave të NEMO-s, Amendimet, Dispozita Tranzitore si dhe Hyrja në fuqi. Në nenin 12 të këtij kapitulli paraqitet procesi i miratimit të tarifave të NEMO-s, parimet e përgjithshme dhe kriteret që këto tarifa duhet të përmbushin.
- Në dispozitën tranzitore, është përcaktuar se kjo metodologji do të jetë e aplikueshme dhe do të shërbejë për përcaktimin e tarifave të NEMO-s për periudhën tarifore të vitit 2026 e në vazhdim. Viti 2025 do të jetë viti i testimit i cili do të shërbejë për vlerësimin e kostove faktike të realizuara nga Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike. Rregullatori do të shqyrtojë propozimin e tarifave nga Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike mbështetur në argumente dhe sqarime sikurse dhe në 'benchmark' me qëllim krahasimin e tarifave me NEMO të tjera rajonale.

- *Shtojca I*, e metodologjisë e cila konsiston në Llogaritjen e të ardhurave të Lejuara të NEMO-s.
 - *Shtojca II*, e metodologjisë përcakton Bazën e Rregulluar të Aseteve me qëllim llogaritjen e amortizimit të lejuar. Kostot e lejuara të amortizimit gjatë periudhës aktuale rregullatore do të zbriten nga Baza e Rregulluar e Aseteve, e llogaritur sipas politikave përkatëse.
 - *Shtojca III*, përshkruan procesin e rishikimit të tarifave të NEMO. Procesi i shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) do të kryhet mbështetur në përcaktimet e ‘Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s’.
- Duke iu referuar argumenteve të paraqitura më lart dhe përfundimit të procesit të konsultimit publik mbi Metodologjinë e përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), përfshirë ndërhyrjet për finalizimin e draftit nga ZRRE dhe ERE, vlerësohet se metodologjia përfundimtare e dakordësuar ka integruar të gjitha komentet dhe sugjerimet e palëve të interesuara. Ajo është në përputhje me parimet rregullatore dhe standardet ligjore në fuqi për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”. (bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojnë shoqërinë Alpex sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)

KAPITULLI I KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Kjo metodologji përcakton:

- 1.1. Bazën dhe procesin për përcaktimin e nivelit të të Ardhurave të Lejuara për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) të cilat mund t'i rikuperojë në çdo vit përkatës në mënyrë që t'i lejojë atij të mbulojë kostot e arsyeshme të operimit dhe mirëmbajtjes së tregut të energjisë elektrike në përputhje me përcaktimet e 'Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të transmetimit të Energjisë Elektrike në Tregun e Bashkuar'.
- 1.2. Parimet me të cilat Tarifat e NEMO-s do të miratohen, rishikohen dhe rregullohen.

Neni 2 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

- 1.1. **“Të ardhurat aktuale të rregulluara”** - të ardhurat që mbulohen nga NEMO përmes tarifave për ofrimin e shërbimeve NEMO dhe çdo njësi tjetër të të Ardhurave të përcaktuara nga Rregullatori, të matura mbi bazën aktuale;
- 1.2. **“Plani i Lejuar i Investimeve”** - programi i projekteve kapitale për Periudhën Rregullatore të lejuar nga Rregullatori;
- 1.3. **“Rregullatori”**- nënkupton sipas rastit, Entin Rregullator të Energjisë të Shqipërisë ose Zyrën e Rregullatorit për Energji në Kosovë;
- 1.4. **“Tarifa për Licencë”** - shuma e pagueshme sipas kushteve të Tarifave të lëshuara nga Rregullatori;

- 1.5. **“Operator i Tregut (OT)”** - person fizik ose juridik, i licencuar nga *Rregullatori*, përgjegjës për operimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike;
 - 1.6. **“Tarifat e Operatorit të Tregut”**- tarifat e përcaktuara për detyrimet që paguhen për funksionimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike, të përcaktuara nga Rregullatori;
 - 1.7. **“Të Ardhurat e Lejuara”** - të ardhurat, të përcaktuara në *Shtojcën I* të kësaj Metodologjie, të cilat mund të rikuperohen në një vit përkatës nga NEMO përmes tarifave;
 - 1.8. **“WACC”** - Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit mbi asetin bazë të rregulluar e cila do të vlerësohet nga Rregullatori (*Shtojca I*); dhe,
 - 1.9. **“Kapitali i Punës”**- fondi i nevojshëm për të përballuar diferencën në kohë midis kryerjes së shpenzimit për sigurimin e shërbimit dhe vjeljes së të ardhurave nga klientët gjatë aktivitetit.
 - 1.10. **“Viti i Testimit”**- një periudhë 12 mujore përpara periudhës rregullatore, e cila përdoret si bazë për përcaktimin e të ardhurave të kërkuara për vitin bazë për Operatorin e Emëruar të tregut të energjisë elektrike.
2. Termat, përkufizimet e të cilave nuk renditen në pikën 1 të këtij neni, do të kenë kuptimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sektorin e energjisë.

KAPITULLI II

RREGULLAT E PËRCAKTIMIT TË TË ARDHURAVE TË NEMO

Neni 3

Parimet e Përgjithshme të përcaktimit të të ardhurave të NEMO-S

1. Ky rregull bazohet në parimet e mëposhtme:
 - 1.1. Të Ardhurat e rregulluara të cilat NEMO pret të fitojë nëpërmjet tarifave do të mbulojnë kostot e arsyeshme për ofrimin e shërbimeve të autorizuara si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike, në masën që këto kosto të jenë të justifikuar dhe të realizuara me kujdes;
 - 1.2. Të Ardhurat e NEMO përcaktohen në mënyrë transparente dhe të paanshme, bazuar në kritere jodiskriminuese;

- 1.3. Të Ardhurat e NEMO sigurojnë qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e veprimtarisë së Operatorëve të Tregut;
 - 1.4. Të Ardhurat e NEMO sigurojnë drejtësi dhe ekuilibër ndërmjet interesave të Operatorit të Tregut dhe interesave të përdoruesve të shërbimeve që i ofron Operatori i Tregut;
 - 1.5. Të Ardhurat dhe tarifat e NEMO synojnë të jenë të parashikueshme dhe të qëndrueshme në masën më të madhe të mundshme; dhe,
 - 1.6. Të Ardhurat dhe tarifat e NEMO do të caktohen për një periudhë 3 vjeçare, përveç periudhës testuese të referuar në dispozitën tranzitore.
2. NEMO do të propozojë tarifa të Operatorit të Tregut (OT) të tilla që të ardhurat që ai pret të fitojë nga këto tarifa të jenë brenda kufijve të përcaktuar nga Rregullatori.

Neni 4 **Rishikimet e Tarifave dhe Periudhat rregulluese**

1. Të Ardhurat e rregulluara do të përcaktohen në Rishikimin e Tarifave.
2. Periudha Rregulluese për të cilën Tarifat NEMO janë në fuqi është një periudhë 3 vjeçare ku kufijtë e miratuar të të ardhurave të rregulluara mbeten në fuqi deri në momentin e Rishikimit të Tarifave të NEMO mbështetur në dispozitat e Shtojcës III
3. Formulatat për llogaritjen e të ardhurave të rregulluara të lejuara janë ato të përcaktuara sipas *Shtojcës I* të kësaj Metodologjie.
4. Procesi i Rishikimit të Tarifave do të shqyrtohet mbështetur në përcaktimet sipas *Shtojcës III* të kësaj Metodologjie.

KAPITULLI III **TË ARDHURAT E LEJUARA TË NEMO-S**

Neni 5 **Parimet për përcaktimin e të ardhurave të rregulluara**

1. Kjo metodologji ka për qëllim vendosjen e parimeve për përcaktimin e të ardhurave të rregulluara të cilat lejojnë përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë elektrike mbështetur në kostot e arsyeshme të aktivitetit të NEMO-s.
2. Rregullatori do të caktojë normën e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC) për NEMO në një nivel që lejon mbulimin e arsyeshëm të kostove kapitale për asetet brenda Bazës së Rregulluar të Aseteve.

3. Të ardhurat e Lejuara do të vendosen në një nivel të tillë që i mundëson NEMO-së të rikuperojë kostot e arsyeshme të shërbimeve që ofron Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike, në masën që këto kosto të jenë të justifikuar.
4. Viti rregullues i të Ardhurave të Lejuara i periudhës rregullatore do të përbëhet nga:
 - 4.1. Baza e Rregulluar e Aseteve;
 - 4.2. Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes;
 - 4.3. Amortizimi i lejuar;
 - 4.4. Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit;
 - 4.5. Tarifat dhe Taksat e Licencës;
 - 4.6. Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës;
 - 4.7. Të ardhurat jo tarifore
5. Në përcaktimin e kostove të arsyeshme, Rregullatori do t'i referohet, por nuk është i detyruar ose i kufizuar në:
 - 5.1. Informacionin ekzistues të periudhave të mëparshme në lidhje me vëllimin, koston dhe cilësinë e shërbimit të NEMO-s;
 - 5.2. Vëllimet e parashikuara, kostot dhe cilësinë e shërbimit në lidhje me NEMO; dhe
 - 5.3. Krahasimet me kostot e Operatorëve të Tregut të ngjashëm në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë ndërmjet Operatorëve të Tregut dhe NEMO-së;
6. Çdo e ardhur tjetër që nuk mbledhet nëpërmjet tarifave të rregulluara, por që lidhet me ofrimin e shërbimeve të ofruara nga NEMO do të zbritet nga të ardhurat e rregulluara të NEMO-s, duke përfshirë çdo ndryshim midis vlerës së asetëve të nxjerra jashtë përdorimit dhe vlerës së tyre rregullatore.

Neni 6

Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes

1. Me paraqitjen e vlerësimeve të tij për kostot fikse dhe kosto të tjera të funksionimit dhe mirëmbajtjes që kërkohen për t'u rikuperuar përmes të ardhurave të rregulluara të lejuara për çdo periudhë të ardhshme rregullatore, NEMO do të kërkojë të rikuperojë vetëm ato pjesë ose elemente të këtyre kostove që mund t'i atribuohen në mënyrë të arsyeshme aktivitetit të tij.
2. Kostot e lejuara të operimit dhe të mirëmbajtjes do të përfshijnë vetëm proporcionin ose elementet e kostove të korporatës (të çdo njësie ekonomike mëmë ose çdo njësie

ekonomike të lidhur) që mund t'i atribuohet në mënyrë të arsyeshme NEMO-s mbështetur në standartet e aplikueshme të kontabilitetit rregullativ.

Neni 7 **Amortizimi i lejuar**

1. Kostot e lejuara të amortizimit do të llogariten mbështetur në sistemin fiskal për llogaritjen e amortizimit për qëllime të rregullimit.
2. NEMO nuk do të lejohet të mbulojë kostot e amortizimit për asetet e financuara nga grantet kapitale dhe kontributet nga palët e treta.

Neni 8 **Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit**

1. Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC) mbi Asetin Bazë të Rregulluar do të përcaktohet nga Rregullatori mbështetur në *Shtojcën I* të kësaj Metodologjie.
2. Vlerat e lejuara të normës së WACC mbi asetin bazë të rregulluar, do të caktohen nga Rregullatori në kuadër të rishikimit të tarifave.
3. Baza e Rregulluar e Aseteve do të përfshijë vetëm asetet të cilat konsiderohen si të shfrytëzuara dhe të dobishme në periudhën e rishikimit të tarifave, duke përjashtuar amortizimin e akumuluar.
4. NEMO nuk do të fitojë kthim mbi asetet e financuara duke përdorur grante kapitale ose kontribute të donatorëve.

Neni 9 **Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës**

1. Të ardhurat e lejuara do të përfshijnë një normë të lejuar të Kapitalit të Punës i cili do të llogarisë kostot afatshkurtra të financimit për të mbuluar diferencën ndërmjet të pagueshmeve dhe të arkëtueshmeve brenda çdo muaji të caktuar.
 - 1.1 Vlera e Lejuar e Kapitalit të Punës do të llogaritet si $\frac{1}{12}$ e shpenzimeve operative sipas formulës së mëposhtme:

$$WCLC = 1/12 * (OPMC + LICC)$$

Neni 10 **Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës**

1. Rregullatori do të lejojë OT-në të mbulojë të gjitha shpenzimet e licencimit dhe shpenzimet tatimore.

KAPITULLI IV TARIFAT E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Neni 11 Parimet e vendosjes së tarifave të NEMO-S

1. NEMO do të propozojë tarifën NEMO për miratim nga Rregullatori në mënyrë që:
 - 1.1. NEMO të mbulojë kostot e operatorit të tij të tregut, për ofrimin e shërbimeve të autorizuara sipas NEMO, deri në nivelin e të Ardhurave të Lejuara të përcaktuara sipas kësaj metodologjie; dhe
 - 1.2. Tarifat NEMO janë në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga NEMO dhe të miratuar nga Rregullatori. Metodologjia specifikon si alokohen kostot për funksionet e Operatorit të Tregut dhe si do të mbulohen nga tarifat.

Neni 12 Procesi i Miratimit të Tarifave të NEMO-s

1. NEMO do t'i dorëzojë Rregullatorit propozimin e tij për Tarifën NEMO dhe çdo ndryshim të mëvonshëm të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë pune para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
2. Asnjë metodologji apo ndryshim i metodologjisë nuk do të jetë në fuqi derisa të miratohet nga Rregullatori.
3. NEMO ka të drejtë të propozojë tarifën NEMO që i nënshtrohen kërkesave të nenit 11.
4. Tarifat e NEMO-s do të synojnë të përmbushin kriteret e mëposhtme:
 - 4.1. Të promovojë funksionimin efikas të sektorit dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike për interesat afatgjata të konsumatorëve;
 - 4.2. Struktura tarifore e NEMO-s duhet të jetë e thjeshtë dhe lehtësisht e kuptueshme nga përdoruesit;

- 4.3. Tarifat e NEMO-s duhet të pasqyrojnë kostot e arsyeshme të tij në masën më të madhe të mundshme;
- 4.4. Tarifat duhet të shmangin diskriminimin ndaj një kategorie ose disa kategorive të anëtarëve;
- 4.5. Struktura tarifore e NEMO-s duhet të jetë lehtësisht e krahasueshme me strukturat rajonale të tarifave të NEMO-s.

Neni 13 Amendimet

1. Rregullatori ruan të drejtën për të ndryshuar ose modifikuar çdo dispozitë të kësaj Metodologjie.
2. Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Metodologjie do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 14 Dispozita Tranzitore

1. Kjo metodologji do të jetë e aplikueshme dhe do të shërbejë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për periudhën tarifore të vitit 2026 e në vazhdim.
2. Viti 2025 do të jetë viti i 'testimit i cili do të shërbejë për vlerësimin e kostove faktike të realizuara prej NEMO. Për vitin e testimit, Rregullatorët do të shqyrtojnë propozimin e tarifave nga NEMO mbështetur në argumente dhe sqarime si dhe në një *benchmark* me qëllim krahasimin e tarifave të propozuara me NEMO-t e tjera rajonale.

Neni 15 Hyrja në fuqi

Kjo Metodologji u miratua me vendimin Nr. 286, datë 20.12.2024 të Bordit të ERE-s.

SHTOJCA I

LLOGARITJA E TË ARDHURAVE TË LEJUARA TË NEMO-S

1. Kjo shtojcë përcakton formulën për llogaritjen e të Ardhurave të Lejuara të NEMO-s e cila ka për qëllim të plotësojë dhe qartësojë zbatimin e parimeve të përcaktuara në këtë Metodologji.
2. Të Ardhurat e Lejuar të NEMO-s (NEMORR) do të llogariten në *Shqyrtimet e Tarifave* duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$NEMORR = (RAB * WACC) + (OPMC + DEPC + WCLC + LICC - NTFR)$$

Ku:

<i>NEMORR</i>	<i>Të Ardhurat e lejuara të NEMO</i>
<i>RAB</i>	<i>Baza e Rregulluar e Aseteve</i>
<i>WACC</i>	<i>Kosto Mesatare e Ponderuar e Kapitalit</i>
<i>OPMC</i>	<i>Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes</i>
<i>DEPC</i>	<i>Kostot e lejuara të Amortizimit</i>
<i>WCLC</i>	<i>Kapitali i Punës</i>
<i>LICC</i>	<i>Tarifa dhe Taksat e Licencës</i>
<i>NTFR</i>	<i>Të Ardhurat jo-tarifore</i>

3. Norma e 'Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit - WACC' mbi bazën e rregulluar të asetëve neto do të përllogaritet sipas formulës në vijim:

$$WACC = [ES * AroE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB;

T - Norma e taksës së korporatës;

ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse;

DS - Objektivi për raportin e borxhit në RAB;

CoD - Kosto e borxhit

4. Rregullatori do të vlerësojë normën e propozuar të Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit të paraqitur nga NEMO krahas normave të tregut lidhur me kthimin e kapitalit dhe koston e borxhit si dhe duke konsideruar krahasim me shoqëri të tjera që kanë risk të njëjtë, historinë si dhe kushtet aktuale financiare dhe ekonomike të NEMO.

SHTOJCA II

BAZA E RREGULLUAR E ASETEVE

1. Kjo shtojcë përshkruan përcaktimin e Bazës së Rregulluar të Aseteve me qëllim llogaritjen e Amortizimit të Lejuar dhe (Neni 7).
2. Baza e Rregulluar e Aseteve do të jetë një vlerë rregullatore e pasurive të paluajtshme të përdorura dhe të dobishme të NEMO-së që janë të nevojshme për ofrimin e Shërbimeve saj. Baza e Rregulluar e Aseteve do të bëjë dallimin ndërmjet klasave të ndryshme të asetëve.
3. Rregullatori do të përcaktojë Bazën e Rregulluar të Aseteve para fillimit të Periudhës së parë Rregullatore.
4. Baza e Rregulluar e Aseteve do të përditësohet në çdo Rishikim Tarifor si më poshtë:
 - 4.1. Kostot e lejuara të amortizimit gjatë periudhës aktuale rregullatore do të zbriten nga Baza e Rregulluar e Aseteve, e llogaritur sipas politikave përkatëse;
 - 4.2. Shitjet ose nxjerjet jashtë përdorimit të asetëve gjatë periudhës aktuale rregullatore do të zbriten nga Baza e Rregulluar e Aseteve në vlerën e tyre të mbetur;
 - 4.3. Baza e Rregulluar e Aseteve nuk përfshin asetet e financuara nga grantet dhe kontributet e palëve të treta;
 - 4.4. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës aktuale rregullatore do t'i shtohen Bazës së Rregulluar të Aseteve gjatë rishikimit të parë tarifor pas datës kur asetit është futur në shërbim dhe me koston e lejuar në planin e lejuar të investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Gjatë Rishikimit të Tarifave, i licencuari mund të kërkojë që kosto aktuale dhe jo ajo e lejuar e një investimi të shtohet në Bazën e Rregulluar të Aseteve. Rregullatori do ta pranojë kërkesën nëse i licencuari mund të demonstrojë qartë se dallimi mes kostove të lejuara dhe atyre aktuale është për shkak të faktorëve jashtë kontrollit të të licencuarit dhe se janë bërë përpjekjet e tij më të mira për të minimizuar rritjen e koston;
 - 4.5. Nëse një projekt kapital në Planin e Investimeve të Lejuara nuk vihet në shërbim në Periudhën Rregullatore Aktuale, kostoja e tij e lejuar nuk do t'i shtohet Bazës së Rregulluar të Aseteve në rishikimin e ardhshëm tarifor;
 - 4.6. Në rastet kur ndonjë kosto e mirëmbajtjes është e përfshirë ose ka qenë përfshirë më parë në kostot e lejuara operative, nuk do të kapitalizohet dhe as nuk do të përfshihet në Bazën e Rregulluar të Aseteve;
 - 4.7. Baza e Rregulluar e Aseteve do të rregullohet duke marrë parasysh normën e inflacionit gjatë periudhës së mëparshme rregullatore, duke përdorur Indekset e

Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit - Të gjithë njësitë për Eurozonën të publikuar nga Eurostat si masë përkatëse; dhe,

- 4.8. Politikat e amortizimit, të përcaktuara nga Rregullatori, në lidhje me jetëgjatësinë e aseteve do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente dhe nuk do të ndryshohen nga i licencuari për qëllime rregullatore.
5. Jetëgjatësia e Aseteve Ekonomike për klasa të ndryshme të aseteve do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve. Jetëgjatësia e Aseteve Ekonomike do të përcaktohet në Rishikimet e të Ardhurave të Rregulluara në mënyrë që ato të pasqyrojnë jetëgjatësinë teknike të aseteve, përveç rasteve kur ka arsye të demonstrueshme se përse jetëgjatësia teknike e një asemi do të ndryshojë nga jetëgjatësia e dobishme ekonomike e një asemi.
6. Shpenzimet e lejuara kapitale do të përcaktohen në Rishikimet e Tarifave bazuar në Planin e Lejuar të Investimeve. Plani i Lejuar i Investimeve do të:
 - 6.1. Përfshijë projektet kapitale të nevojshme, në mënyrë të arsyeshme, për të ofruar Shërbime të Operatori të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike;
 - 6.2. Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
 - 6.3. Zhvillohet duke përdorur një analizë të kostove dhe përfitimeve të zbritura të projektit kapital.
7. Plani i Investimeve të Lejuara do të zbatohet si më poshtë:
 - 7.1. NEMO do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar zbatimin e Planit të Investimeve të Lejuara në përputhje me afatet e lejuara;
 - 7.2. Nëse NEMO nuk është ose nuk do të jetë në gjendje që, për arsye jashtë kontrollit të tij, të ndërmarrë një projekt kapital në përputhje me afatin e dhënë në Planin e Investimeve të Lejuara, ai do të njoftojë Rregullatorin. Gjithashtu NEMO do të ofrojë detaje mbi arsyet e vonësës dhe afatin e rishikuar;
 - 7.3. NEMO në çdo kohë mund të aplikojë tek Rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital alternativ me një projekt tjetër kapital në Planin e tij të Lejuar të Investimeve për aq kohë sa projekti alternativ pritet të rezultojë në përfitime neto të njëjta ose më të mëdha për konsumatorët (duke marrë parasysh rezultatet dhe kostot e pritshme). Nëse Rregullatori njezh zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet Bazës së Rregulluar të Aseteve në rishikimin e ardhshëm periodik të përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike; dhe
 - 7.4. Nëse NEMO zëvendëson një projekt kapital alternativ me një projekt tjetër kapital në Planin e tij të Investimeve të Lejuar, pa vënien paraprakisht në dijeni Rregullatorin, atëherë Rregullatori do të vlerësojë nëse do ta njohë zëvendësimin e tij në Rishikimin e ardhshëm të të Ardhurave të Rregulluara gjatë procesit të

përcaktimit të tarifave të NEMO, por nuk është i detyruar ta pranojë këtë zëvendësim.

- 7.5. Në çdo rast Plani i Investimeve do të përcillet bashkë me Aplikimin për përcaktimin e Tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si pjesë përbërëse e shpenzimeve kapitale të parashikuara që do të shërbejnë për përlogaritjen e të ardhurave të rregulluara mbështetur në përcaktimet e kësaj Metodologjie.

SHTOJCA III

PROCESI I RISHIKIMIT TË TARIFAVE

1. Rregullatori, me qëllim të promovimit të transparencës, do të publikojë aplikimin për përcaktimin e tarifave, materialet, dokumentacionin plotësues të dërguar nga NEMO si dhe komentet nga palët e interesuara në lidhje me aplikimin në faqen e tij zyrtare, duke përfshirë vetëm informacionet e cilësuar si konfidenciale.
2. Kërkesa për rishikim të tarifave mund të iniciohet përmes një apo më shumë proceseve në vijim:
 - 2.1. Inicimi nga Rregullatori i Shqyrtimit Periodik pas përfundimit të çdo periudhe tarifore 3 vjeçare;
 - 2.2. Inicimi nga Rregullatori apo NEMO si pasojë e ndonjë ndryshimi të rëndësishëm në rrethanat që ekzistojnë në kohën e miratimit të të Ardhurave të Lejuara;
3. Me pranimin e kërkesës nga paragrafi 2 i kësaj Shtojce, ose nëse kompania nuk paraqet kërkesë tek Rregullatori për uljen e të Ardhurave të Lejuara, në kushtet e paraqitjes së rasteve nga paragrafi (2) i këtij neni, Rregullatori miraton një vendim për fillimin e procedurës për rishikimin e të Ardhurave të Lejuara dhe ia dorëzon NEMO-së.
4. Afatet për procesin e përgjithshëm të rishikimit do të përcaktohen nga Rregullatori gjatë fillimit të procesit të rishikimit.
5. Rregullatori do të iniciojë Rishikimin e Tarifave duke njoftuar NEMO-në për:
 - 5.1. Të dhënat për vitet aktuale dhe të parashikuara, sipas kërkesës;
 - 5.2. Formati në të cilin kërkohet të dorëzohen të dhënat;
 - 5.3. Afatin për dorëzimin e Propozimit të NEMO-së për të Ardhurat e Lejuara për periudhën e ardhshme rregullatore.
6. Propozimi i NEMO-s do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet e mëposhtme (pa kufizim):
 - 6.1. Të Ardhurat aktuale të rregulluara dhe norma aktuale e kthimit nga investimet e fituara gjatë vitit të fundit rregullator dhe vitit të kaluar rregullator;
 - 6.2. Kostot aktuale të ofrimit të Shërbimeve të NEMO-s gjatë periudhës aktuale rregullatore, në përputhje me përkufizimin e kostove që janë përdorur për llogaritjen e të Ardhurave të Lejuara;

- 6.3. Raportin e auditimit dhe pasqyrat financiare të audituara për çdo vit financiar që ka përfunduar në Periudhën Rregullatore aktuale, kur këto janë të disponueshme, siç kërkohet nga kërkesat raportuese të përfshira në licencat e OT-së;
 - 6.4. Kërkesa aktuale për anëtarësim dhe totali i Anëtarëve të Bursës gjatë periudhës aktuale rregullatore;
 - 6.5. Parashikimi i Kërkesës dhe Anëtarësimet e pritshme për Periudhën e ardhshme Rregullatore;
 - 6.6. Parashikimi i të Ardhurave Maksimale të Lejuara, duke raportuar secilin nga komponentët e kostos së lejuar veçmas, për Periudhën e ardhshme Rregullatore.
 - 6.7. Çdo studim i porositur nga OT në lidhje me ndonjë nga çështjet që do të përfshihen në Propozimin e NEMO-s; dhe
 - 6.8. Çdo material tjetër shtesë që Rregullatori e konsideron të arsyeshëm se duhet të përfshihet në propozimin e NEMO-së, për sa kohë që Rregullatori ka njoftuar NEMO-në një kohë të arsyeshme para afatit përfundimtar për propozimin e NEMO-s.
 - 6.9. Të ardhurat e realizuara nga tarifat NEMO mbi/nën nga ato të lejuara të cilat do të korigjohen në periudhën pasardhëse rregullatore.
7. Në përgatitjen e propozimit të tij, NEMO, për sa është e mundshme, do të zbatojë parimet dhe formulat e përcaktuara në këtë Metodologji.
 8. Në rastet kur NEMO nuk ka zbatuar parimet dhe formulat, në përputhje me këtë Metodologji, NEMO do të zbulojë çdo fushë ku nuk i ka zbatuar këto parime, arsyen e moszbatimit të tyre, arsyet që mbështesin qasjen alternative dhe të japë një vlerësim të ndikimit të përdorimit të qasjes alternative.
 9. Pas marrjes së propozimit të NEMO-së, Rregullatori do të përcaktojë saktësinë, rëndësinë dhe arsyeshmërinë e tij duke zbatuar metodologjinë e përcaktuar dhe duke përfshirë përcaktimin nëse të Ardhurat e Lejuara të propozuara reflektojnë kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve të NEMO-s.
 10. Rregullatori do të përgatisë një Vlerësim të Përkohshëm të Propozimit të NEMO-së brenda një kohe të arsyeshme (të përcaktuar në paragrafin 4 të kësaj Shtojce) pas shqyrtimit të propozimeve të NEMO-së dhe konsultimit me NEMO-në. Vlerësimi i Përkohshëm do të përcaktojë propozimet e Rregullatorit për të Ardhurat e lejuara që do të rikuperohen nga NEMO gjatë periudhës rregullatore dhe arsyetimin për këto. Rregullatori, në përgatitjen e vlerësimit të tij të përkohshëm, mund të ndryshojë, heqë ose zëvendësojë çdo pjesë të Propozimit të NEMO-së ,ashtu si e konsideron të përshtatshme, me kusht që të identifikojë ndryshime, heqje ose zëvendësime të tilla dhe të japë arsyetim për ato.

11. Procesi i shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike do të kryhet mbështetur në përcaktimet e ‘Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s’.
12. NEMO mund të ankimojë vendimin e Rregullatorit lidhur me përcaktimin e tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike në përputhje me legjislacionin në fuqi.